



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



MIRATUAR NGA:

Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës në Gjakovë

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica - Municipality of Gjakova

ARKIVA HYRËSE
UVODNI ARHIV
INTRODUCTORY ARCHIVES

Njësia O.I.O./J.O. 01
Numri i Str./No. 082101-24051
Nr. Faqëve/Br./Str./No./Pg. 1

Data/Datum/Date 21.12.2023
Pranoj/Prhvati/Accept

Gjakovë - Djakovica - Gjakova

PLANI STRATEGJIK

Për Njësinë e Auditimit të Brendshëm

në Komunën e Gjakovës
për vitet 2024, 2025 dhe 2026

06/12/2023

I. HYRJE

1.1 Pasqyra

Ky plan strategjik prezanton objektivat kryesorë, prioritetet dhe fushëveprimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm në Komunën e Gjakovës, për periudhën 2024, 2025 dhe 2026. Ato janë në pajtueshmëri me qëllimet dhe planet e organizatës të përcaktuara në baze të Statutit të Komunës, Kornizës afatmesme buxhetore tri vjetore (2024, 2025 dhe 2026), Ligjit mbi financat publike, Ligjit mbi prokurimin, rregulloret dhe udhëzimet e aplikueshme të thesarit si dhe të gjeturat e auditimeve të ma hershme.

Plani strategjik është zhvilluar në bazë të vlersimit të rrezikut dhe në pajtim me ligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike, standardet e auditimit të brendshëm, kodin e etikës së auditorëve të brendshëm, statutin e njësisë së auditimit të brendshëm dhe metodologjinë për auditimin e brendshëm në sektorin publik të përgatitur nga njësia qendrore harmonizuese për auditimin e brendshëm.

Plani strategjik është zhvilluar në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe në pajtim me ligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike, standardet e auditimit të brendshëm, kodin e etikës së auditorëve të brendshëm, statutin e NjAB dhe metodologjinë për Auditimin e Brendshëm (AB) në sektorin publik të përgatitur nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm (NJQHAB).

Ky plan strategjik siguron bazat për zhvillimin e planeve vjetore të aktiviteteve të auditimit të brendshëm të cilat do të përkufizojnë temën, fushëveprimin, objektivat dhe kërkesat e burimeve për implementimin e secilës detyrë të auditimit

1.2 Struktura, funksionet dhe fushëveprimi i auditimit të brendshëm në organizatë

Funksioni i auditimit të brendshëm në organizatë realizohet nga Njësia e auditimit të brendshëm, e cila është themeluar në sajë të Ligjit mbi auditimin e brendshëm dhe rregulloreve përkatëse.

Njësia e Auditimit të brendshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve të brendshme të të gjitha njësive strukturale, programeve, aktiviteteve dhe proceseve në organizatë.

1.3. Azhurnimi i planit strategjik

Ky plan strategjik duhet të rishikohet dhe azhurnohet çdo vit për të reflektuar çdo ndryshim që ndodhë në objektivat, prioritetet dhe aktivitetet e Komunës dhe në bazë të vlerësimit të rrezikut.

Pas skadimit të periudhës prej 3-vitesh të mbuluar nga ky Plan strategjik, duhet të kryhet një ri-vlerësim gjithëpërfshirës i rrezikut.

Drejtori i Njësies së Auditimit të brendshëm mund ta azhurnojë më shpesh Planin strategjik sipas gjykimit të tij/saj, sipas nevojës. Çdo ndryshim i Planit strategjik duhet të miratohet nga kryesuesi i organizatës.

II. TË KUPTUARIT E AKTIVITETEVE TË ORGANIZATËS

Kryesisht Plani strategjik i NjAB është hartuar në bazë të vlerësimit nga Udhëheqësi i NjAB për fushat më me rrezik të bazuara në Legjislacionin në fuqi dhe nga nevoja për përcaktimin e Universit të auditimit.

NJAB ka filluar procesin e planifikimit strategjik duke bërë një rishikim të qëllimeve, njësive strukturale dhe aktiviteteve të organizatës. Rishikimi është bazuar në informacionet e grumbulluara përmes takimeve dhe intervistave me menaxhmentet e drejtorive komunale, zyrtarë të ndryshëm komunal, nga përgjigjet e tyre në pyetsorë, pastaj nga analizat e rezultateve të dalura nga auditimet e mëparshme, nga informacionet që ofrojnë qasje publike si dhe nga burime të tjera.

2.1. Qëllimet e organizatës

Komuna rregullon dhe udhëheq çështjet publike, brenda territorit të saj të përcaktuara me Ligj, për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë për të gjithë qytetarët. Komuna gjithashtu kujdeset për çështjet me interes të përgjithshëm, që ndërlidhen me Komunën dhe që nuk janë objekt shqyrtimi apo rregullimi të institucioneve qendrore apo të ndonjë organi tjetër jo të Komunës.

Organet e Komunës së Gjakovës, kujdesen që të gjithë qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik, apo mendimi tjetër, prejardhjes kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale në të gjitha nivelet. Komuna e Gjakovës në territorin e vet, në kuadër të ligjeve ekzistuese, është, përgjegjëse dhe ushtron pushtetin mbi këto aktivitete:

- Zhvillimin lokal ekonomik;
- Planifikimin urban dhe rural;
- Shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- Zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- Mbrojtjen e mjedisit lokal;
- Ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale;
- Përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut
- Ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
- Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave të përkujdesit, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- Banimin publik;
- Shëndetësinë publike;

- Licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- Emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;
- Turizmit;
- Aktivitetet kulturore dhe të lira;
- Çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është paracaktuar një autoriteti tjetër.

2.2. Ndryshimet e pritura në Komunë

Plani strategjik do të azhurnohet për çdo vit dhe do t'i përshtatet ndryshimeve, të cilat do të ndodhin gjatë periudhës tri-vjeçare të cilat mund të rrjedhin si rezultat i miratimit të Ligjeve, ndryshimeve në strukturën organizative të Komunës, mundësisë së transferimit të kompetencave nga niveli qendror në atë lokal dhe përdorimit më efikas të sistemeve të IT-së të instaluar në Komunë si: e-pasuria, e-qeverisja, sistemi për tatimin në pronë (PROTAX). Fillimi i përdorimit të sistemit E-Prokurimi

2.3. Niveli i kontrollit në Komunë.

Niveli i kontroleve të brendshme në organizatë është në rend të parë i përcaktuar me:

Kornizë ligjore

- Ligjet ekzistuese në Kosovë,
- Rregulloret,
- Udhëzimet administrative,
- Urdhëresat administrative.

Dokumente strategjike dhe plane zhvillimore

Komuna ka hartuar një sërë planesh për fusha specifike si: Plani zhvillimor komunal dhe Plani zhvillimor urban të cilat në përgjithësi parashikojnë planifikimin hapësinor komunal.

NjAB vlerëson se me gjithë përpjekjet e Komunes, Zyra Kombëtare të Auditimit për vitin 2020 në raportin e sajë, del se Komuna duhet ti kushtojë më tepër vëmendje në fushave si:

- Kontrollat menaxheriale;
- Menaxhimit të kontratave
- Realizim të buxhetit dhe
- Menaxhimit të pasurisë.

III. OBJEKTIVAT STRATEGJIK TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Në bazë të të kuptuarit tonë të objektivave, prioriteteve, aktiviteteve dhe nivelit të kontrollit në organizatë gjatë periudhës 2024, 2025 dhe 2025, NJAB ka identifikuar objektivat strategjik në vijim:

3.1 Objektivat kryesore të planit strategjik janë:

- > Theksimi i rëndësisë për zbatimin e ligjshmërisë gjatë kryerjes së aktiviteteve nga zyrtarët Komunal;
- > Theksimi i rëndësisë së vendosjes dhe funksionimit të Kontrollit të Brendshëm;
- > Theksimi i rëndësisë mbi procesin e krijimit të të hyrave dhe shfrytëzimit (shpenzimit) të tyre;
- > Theksimi i rëndësisë lidhur me politikën e komunikimit/ raportimit midis niveleve komunale në vijat horizontale dhe vertikale të menaxhimit.

Detyrat dhe aktivitetet specifike të NJAB (për secilin vit të mbuluar nga ky plan) të cilat reflektojnë këto objektiva strategjike do të prezantohen në planet vjetore të aktiviteteve të auditimit të brendshëm.

IV. UNIVERSI I AUDITIMIT

4.1 Universi i Auditimit, është, përcaktuar për qasje të kombinuar–funktionale dhe strukturore.

Universi i auditimit do të realizohet duke kryer:

- rishikimin e ndryshimeve të aktiviteteve të komunës,
- rishikimin e proceseve të menaxhimit të buxhetit,
- rishikimin e proceseve të arkëtimit të hyrave,
- rishikimin e proceseve të shpenzimit të parave publike,
- rishikimin e proceseve të prokurimit,
- rishikimin e proceseve të menaxhimit të pasurisë,
- rishikimin e proceseve llogarive bankare,
- rishikimin e proceseve të raporteve, krahasimi i raporteve kontabël me evidencën e free-balancit

Në kuadër të universit të auditimit do të përfshihen këto aktivitete të auditimit:

- Procesi i prokurimit,
- Të hyrat nga tatimi në pronë,
- Të hyrat nga lejet e ndërtimit,
- Menaxhimi i sistemit të pagave

- Menaxhimi i kontratave,
- Menaxhimi i pasurisë,
- Ekzekutimi i buxhetit në drejtorinë e Infrastrukturës Lokale.
- Rekrutimi i
-
- 200 në administratën komunale,
- Ekzekutimi i buxhetit në drejtorinë e Arsimit,
- Ekzekutimi i buxhetit në drejtorinë e Shëndetësisë,
- Të hyrat në drejtorinë e Shërbimeve Publike,
- Ekzekutimi i buxhetit për subvencionet në Drejtorinë e Kulturës,
- Mbledhja e të hyrave në drejtorinë e Kadastrit,
- Ekzekutimi i buxhetit për subvencionet në drejtorinë për Ekonomi dhe zhvillimit,
- Ekzekutimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet në drejtorinë e administratës.
- Mbledhja e të hyrave në drejtorinë e inspektionit.
- Menaxhimi i parasë e imët (Petty Cash).

V. VLËRËSIMI I RREZIKUT

5.1 Faktorët e rrezikut dhe rëndësia e tyre, faktorët e rrezikut që të vendosin për angazhimet me prioritet si:

- Cilësia e kontrolleve të brendshme;
- Kompleksiteti dhe madhësia e operacioneve;
- Ndikimi financiar;
- Koha e angazhimit të fundit të auditimit;
- Rregullat ligjore ose kontraktuale;
- Ndërrimet e fundit në aktivitet ose proces;
- Kompetenca e menaxhmentit;
- Marrëdhëniet e punonjësit dhe qeverisë komunale;
- Niveli profesional i personelit dhe lëvizja e personelit (ndërrimet e shpeshta të stafit);
- Ndryshimet e aktiviteteve dhe strukturës së komunës;
- Ndryshimet amendamenteve të rregulloreve statusore;
- Kompleksiteti i rregulloreve;
- Raportet ndërinstucionale , etj.

5.2 shkalla e gradimit

Shkalla e gradimit për faktorët e rrezikut në planin strategjik 2024–2026, do të jetë prej 1 deri në 3 e përcaktuar nga NjAB.

5.3 Kufijtë e priorizimit

Në rast se indeksi për rrezikun minimal është 1 dhe indeksi për rrezikun maksimal është 3, drejtori i NjAB-it duke u bazuar në gjykimin profesional ka zgjedh pragjet e mëposhtme:

Sistemet me indeksin e rrezikut prej 2.31 deri në 3.00 janë rreziqe të larta;

Sistemet me indeksin e rrezikut prej 1.71 deri në 2.30 janë rreziqe mesatare;

Sistemet me indeksin e rrezikut prej 1.00 deri në 1.70 janë rreziqe të ulëta.

5.4 Rezultatet nga vlerësimi i rrezikut Referoju tabelave të mëposhtme.

VI. QASJA E AUDITIMIT

Strategjia e auditimit përkufizon qasjen e NJAB për mbulimin e universit të auditimit për periudhën 2024, 2025 dhe 2026.

6.1. Shpeshtësia

Proceset e vlersuara me shkalle te rrezikshmeris se lart jane te parapara te auditohen çdo vit.

Procest e vlersuara me shkalle te rrezikshmeris se mesme parashihen te auditohen çdo te dytin vit.

Proceset e vlersuara me shkalle te rrezikshmerise se ulet parashihen te auditohen çdo tri vite.

RREZIKU I LARTË

- Procesi i prokurimit,
- Të hyrat nga tatimi në pronë,
- Subvencionet dhe Grantet,
- Të hyrat nga lejet e ndërtimit,
- Menaxhimi i sistemi të pagave,
- Menaxhimi i Projekteve,
- Menaxhimi i pasurisë,
- Menaxhimi i parkut të automjeteve,
- Menaxhimi i Kontratave.

RREZIKU I MESËM

- Rekrutimi i në administratën komunale,
- Ekzekutimi i buxhetit në drejtorinë e Arsimit,
- Ekzekutimi i buxhetit në drejtorinë e Shëndetësisë,
- Te hyrat në drejtorinë e Shërbimeve Publike,
- Ekzekutimi i buxhetit për subvencionet në Drejtoria e Kulturës,
- Mbledhja e të hyrave në drejtorinë e Kadastrit,
- Ekzekutimi i buxhetit për mallra dhe shërbime në drejtorinë e administratës,
- Mbledhja e të hyrave në drejtoria e inspekcionit.

RREZIKU I ULËT:

- Paraja e gatshme (e imët);
- Donacionet,
- Shpenzimet komunale (shpenzimet për rrymë, telefon,ujë,mbeturina etj.),
Shpenzimet e reprezentacionit

6.2. Kohëzgjatja e detyrave të auditimit

Detyrat e auditimit për shërbime sigurie – kohëzgjatja standarde duhet të përcaktohet në ditë pune për person varësisht nga vlerësimi i rrezikut.

VLERËSIMI I RREZIKUT	DITËT PËR DETYRËN E AUDITIMIT
Rreziku i lartë	- 3 vite nga 35 ditë për aktivitet të auditimit për 1 auditorë = 350 ditë (10 aktivitete X 35 dite 350 ditë) - 35 ditë për një cikël të auditimit
Rreziku i mesëm	- 3 vite nga 20 ditë për aktivitet për 1 auditorë = 100 ditë 5 aktivitete X 20 ditë = 100 ditë - 20 ditë për një cikël të auditimit
Rreziku i ulët	- 3 vite nga 10 ditë për aktivitet për 1 auditorë = 20 ditë 1 aktivitete X 10 ditë = 10 ditë - 10 ditë për një cikël të auditimit

Tabela 1. Ditët për detyra të auditimit

Përcjellja e rekomandimeve – një kohëzgjatje standarde për 5-20 ditë të punës është përcaktuar për përcjelljen e implementimit të rekomandimeve.

Llojet e tjera të punës së auditimit:

Kohëzgjatja standarde e llojeve të tjera të punës së auditimit, si:

- veprimet e veçanta të përcjelljes së auditimit,
- auditime të paparishikueshme AD HOC,
- auditimi i kualitetit të punës,

6.3. Ndarja e detyrave për auditorë

Detyrat e lidhura me aktivitetet e auditimit të brendshëm për secilin punëtor të NJAB gjatë vitit përkatës janë ndarë si vijon:

- 70.30 % e ditëve për implementimi i detyrave të auditimit për shërbimet e sigurisë dhe shërbimet e konsulentësh, (pra nga 216 ditë pune për detyra të auditimit dhe implementim të rekomandimeve, janë paraparë 152 ditë ose 70.30 % e ditëve).

- 9.26 % e ditëve, është ndarë për planifikimin strategjik dhe vjetor; (nga gjithsejtë 216 ditë pune për planifikimin strategjik, janë paraparë 20 ditë ose 9.26 %).
- 4.63 % e ditëve, është paraparë për aktivitetet administrative ; (nga 216 ditë për aktivitete administrative janë paraparë 10 dite ose 4.62 % e ditëve)
- 15.74 % e ditëve, është paraparë për llojet e tjera të aktiviteteve, si aktivitetet e trajnimit, EVP seminarët, etj. (nga 216 ditë për aktivitete të trajnimit janë paraparë 34 dite ose 15.74 %).

Kjo përlogaritje është bërë vetëm për një vit.

Me që jemi të informuar se fazat e trajnimeve për auditor të brendshëm do të vazhdojnë edhe në vitet e ardhshme, atëherë mbetet që përlogaritja e mësipërme të mbetet e njëjtë edhe për dy vite tjera, pra për tërë ciklin e këtij Plani Strategjik

VII. NEVOJAT E AUDITIMIT PËR PERSONEL

7.1. Koha efektive e punës (KEP)

Koha efektive e punës për implementimin e planit strategjik është i bazuar në stafin, të cili e disponon NjAB. Një auditor ka kohë efektive të punës 216 ditë në vit. Koha efektive e punës së stafit për tri vitet e ardhshme është 648 ditë..

7.2. Ndarja e detyrave të auditimit për 3 vite dhe ditë për person, të nevojshme për implementimin e tyre.

Detyrat e auditimit dhe ditët e nevojshme janë ndarë për 3 vite, në pajtim me metodologjinë e përcaktuar në doracakun për AB në sektorin publik të përgatitur nga NJQHAB dhe nevojat për personel për përmbushjen e detyrave të NjAB.

Faktorët e rrezikut	Kriteri i gradimit	Grada
Qarkullimi (lëvizja) i personelit	Nuk ka pasur ndërrime në personelin menaxherial apo të ekspertëve gjatë 3 viteve të fundit.	1
	Një qarkullim prej më pak se 10% të personelit në nivel ekspertësh dhe asnjë ndryshim në personelin menaxherial gjatë 3 viteve të fundit.	2
	Ndryshim në personelin menaxherial dhe qarkullim (lëvizje) i më shumë se 10% në personelin ekspert gjatë 3 viteve të fundit.	3
Ndryshime në	Nuk ka pasur ndryshime strukturore ose ndryshime në aktivitetet apo funksionet gjatë 3 viteve të fundit.	1

aktivitete dhe strukturën e organizatës	Nuk ka pasur ndryshime në aktivitete ose funksione, por një numër i ndryshimeve të vogla (të parëndësishme) strukturale gjatë vitit të fundit.	2
	Ka pasur ndryshime në aktivitetet, caktim të funksioneve të reja ose ndryshime të rëndësishme strukturale gjatë vitit të fundit.	3
Amendamentet e rregulloreve statutore	Nuk ka pasur amendamente në rregulloren statutore gjatë vitit të fundit.	1
	Aktet statutore janë ndryshuar gjatë dy viteve të fundit, por nuk janë adaptuar kërkesa të reja specifike ose akte.	2
	Ekzistimi i amendamenteve të rëndësishme të rregulloreve statutore dhe janë prezantuar kërkesat e reja që afektojnë njësitë e synuara të auditimit.	3
Kompeksiteti i rregulloreve statutore	Rregulloret statutore përmbajnë kërkesat strikte dhe të qarta dhe janë të aplikueshme për një numër të madh të organizatave në sektorin publik.	1
	Rregulloret statusore përmbajnë kushte që i përkasin në mënyrë specifike njësisë së synuar të auditimit.	2
	Aktet statutore përmbajnë rregullore komplekse që ndërrohen shpesh.	3
Buxheti	Deri në 1.000.000 €.	1
	Nga 1.000.001 € deri në 3.000.000 €.	2
	Më shumë se 3.000.000 €.	3
Kontrolli i brendshëm	Të gjitha komponentët e kontrollit të brendshëm ekzistojnë në organizatë dhe menaxhmenti është i vetëdijshëm për çështjet e kontrollit të brendshëm dhe kupton esencën dhe rëndësinë e kontrolleve të brendshme.	1
	Nuk ekzistojnë të gjitha komponentët e kontrollit të brendshëm në organizatë, por menaxhmenti kupton mirë esencën e kontrollit të brendshëm dhe ka dëshirë ta përmirësojë dhe avancojë atë.	2
	Kontrolli i brendshëm është i dobët dhe menaxhmenti nuk e kupton esencën, rëndësinë ose nevojën për të vendosur mekanizmat e kontrollit të brendshëm.	3

Tabela 2. Kriteret e gradimit sipas faktorëve të rrezikut

Njësitë e synuara të auditimit	FAKTORËT E RREZIKUT							Treguesi rrezikut
	FRR 1	FRR 2	FRR 3	FRR 4	FRR 5	FRR 6	Rëndësia	
	Grada	0.20	0.05	0.10	0.15	0.30	0.20	
Departamenti i Prokurimit - Procesi i prokurimit	3	3	3	3	3	3	L	3.00
Drejtoria e Urbanizmit - Të hyrat nga lejet e ndërtimit	3	1	2	2	3	3	L	2.33
Drej. Financave dhe pronës - Te hyrat nga tatimi në pronë	3	3	3	3	3	3	L	3.00
Drej. për Infrastrukturë - Menaxhimi projekteve	3	3	3	3	3	3	L	3.00
Drej. e Financave - Menaxhimi i pasurisë (të hyrat nga Qiratë)	3	2	3	2	3	3	L	2.66
Drej. Financave dhe pronës - Ekzekutimi i buxhetit Inkasimi i mjeteve Pagesa e obligimeve	3	2	2	3	3	3	M	2.66
Drej. Për Bujqësi, Pylltari Dhe Zhvillim Rural	3	3	3	3	3	3	M	3
Drej. e Arsimit - Ekzekutimi i buxhetit DKA	2	2	1	1	3	2	M	1.83
Drej shëndetësisë - Ekzekutimi i buxhetit DSH	2	2	2	2	1	2	M	1.83
Drej. Shërbimeve publike - Të hyrat në drejtorinë e Shërbimeve Publike	1	3	2	2	2	2	M	2.00
Drej. e Kulturës - Ekzekutimi i buxhetit për subvencionet Drejtoria e Kulturës	2	2	2	2	2	3	M	2.17
Drej. Kadastrit - Mbledhja e të hyrave në drejtorinë e Kadastrit dhe punët administrative - operative.	3	3	2	2	2	3	L	2.50
Drej. për ekonomi dhe zhvillim -Ekzekutimi i buxhetit për subvencionet në drejtoria për Ekonomi dhe zhvillimit	2	2	2	2	2	2	M	2
Drej. Administratës - Ekzekutimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet në drejtoria e administratës	2	2	2	1	1	3	M	1.83

Drej, Inspektionit - Mbledhja e të hyrave në drejtoria e inspektionit	1	1	1	1	1	2	U	1.17
Drejt. Administratës - Menaxhimi i parasë e imët (Petty Cash)	1	1	1	1	1	2	U	1.17
Donacionet	1	1	1	2	1	2	U	1.33
Drej. Shërbimeve publike - Menaxhimi i buxhetit për ndriçimin publik	1	1	2	1	1	1	U	1.17
Drej. e Administratës - Shpenzimet komunale në drejtorinë e administratës.	2	1	1	1	1	1	U	1.17
Drej. Administratës - Menaxhimi i parkut të automjeteve	2	2	2	2	2	2	U	2
Drejtoria e Administratës - Ekzekutimi i buxhetit për shpenzimet e reprezentacionit	1	1	1	1	1	1	U	1.00

Tabela 3. Vlerësimi i rrezikut

Përkufizimi i faktorit të rrezikut	
Të dhënat e faktorit të rrezikut	Përshkrimi i faktorëve të përkufizuar të rrezikut (referohuni në pjesën "faktorët e rrezikut")
FRR1	Qarkullimi i personelit
FRR2	Ndryshimet e aktiviteteve dhe struktura e organizatës
FRR3	Amendamentet e rregulloreve statusore
FRR4	Kompleksiteti i rregulloreve statusore
FRR5	Buxheti
FRR6	Kontrolli i brendshëm

Tabela 4. Përkufizimi i faktorit të rrezikut

RANGIMI							
	Faktori i rrezikut	FRR1	FRR2	FRR3	FRR4	FRR5	FRR6
	Rëndësia	0.20	0.10	0.10	0.15	0.30	0.20
Nr.	Fushat e Auditimit						
1	Procesi i prokurimit	0.60	0.10	0.20	0.45	0.90	0.60

2	Të hyrat nga lejet e ndërtimit - Procesi për nga lejet e ndërtimit.	0.60	0.10	0.20	0.45	0.90	0.60
3	Të hyrat nga tatimi në pronë	0.60	0.10	0.20	0.30	0.90	0.60
4	Drej. Shërbimeve publike - Ekzekutimi i buxhetit Menaxhimi projekteve	0.60	0.10	0.20	0.30	0.90	0.60
5	Menaxhimi i pasurisë	0.60	0.20	0.20	0.30	0.90	0.60
6	Menaxhimi i Projekteve	0.60	0.20	0.30	0.30	0.90	0.60
7	Rekrutimi i në Administratën komunale	0.40	0.20	0.20	0.15	0.60	0.40
8	Ekzekutimi i buxhetit në drejtorinë e Arsimit	0.60	0.10	0.20	0.15	0.60	0.40
9	Ekzekutimi i buxhetit në drejtorinë e Shëndetësisë - Menaxhimi projekteve	0.40	0.20	0.10	0.15	0.90	0.40
10	Të hyrat e shpenzimet në drejtorinë e Shërbimeve Publike	0.40	0.20	0.20	0.30	0.30	0.40
11	Ekzekutimi i buxhetit për subvencionet në Drejtoria e Kulturës	0.20	0.30	0.20	0.30	0.60	0.40
12	Mbledhja e te hyrave në drejtorinë e Kadastrit	0.40	0.20	0.20	0.30	0.60	0.60
13	Ekzekutimi i buxhetit për subvencionet në drejtoria për Ekonomi dhe zhvillimit	0.60	0.30	0.20	0.30	0.60	0.40
14	Ekzekutimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet në drejtoria e administratës	0.20	0.20	0.10	0.30	0.90	0.40
15	Mbledhja e te hyrave në drejtoria e inspektionit	0.40	0.20	0.20	0.15	0.30	0.60
16	Menaxhimi i parasë e imët (Petty Cash)	0.20	0.10	0.10	0.15	0.30	0.40
17	Donacionet	0.20	0.10	0.10	0.15	0.30	0.40
18	Menaxhimi i buxhetit për ndriçimin publikë	0.20	0.10	0.10	0.30	0.30	0.40

19	Shpenzimet komunale ne drejtorinë e administratës. (shpenzimet për rrymë, telefon, ujë, mbeturina etj.)	0.20	0.10	0.20	0.15	0.30	0.20	
20	Menaxhimi i parkut të automjeteve	0.40	0.10	0.10	0.15	0.30	0.20	
21	Ekzekutimi i buxhetit për shpenzimet e reprezentacionit	0.20	0.10	0.10	0.15	0.30	0.20	

Tabela 5. Rangimi

PËECAKTIMI I KOHËS EFEKTIVE

Tabela

Auditorët	Gjithsej ditë punë-numri	Pushimi apo	Pushim mjekësor	Koha efektive e punës	Implementi detyrave të auditimit	Trajnimi dhe kualifikimi	Gjithsej aktivitetet administrat	Planifikimi strategjik dhe vjetor
	1	2	3	4	5	6	7	8
Auditori	750	72	30	648	486	72	30	60
GJITHSEJ	750	72	30	648	486	72	30	60

Tabela 6. Përcaktimi i kohës efektive

Rreziku	Kufijtë e prioritizimit	Aktivitetet për vite		
		2024	2025	2026
I lartë	2.31- 3.00	5	6	6
I mesëm	1.71 - 2.30	0	0	0
I ulët	1.00 - 1.70	0	0	0

Tabela 7. Aktivitetet sipas rrezikshmërisë 2024 – 2026

NDARJA E DETYRAVE PËR 2024, 2025, 2026
NË PAJTIM ME STRATEGJINË E AUDITIMIT DHE PËRCAKTIMI I DITËVE TË
NEVOJSHME TË PUNËS PËR PERSON

#	Njësitë e synuara të auditimit	Treguesi i rrezikut	Prioriteti	Detyra #	Ditë punë për person sipas strategjisë		Detyra #	Ditë punë për person sipas strategjisë		Detyra #	Ditë punë për person sipas strategjisë	
					2024	Gjithsej		2025	Gjithsej		2026	Gjithsej
1	Departamenti i Prokurimit - Procesi i prokurimit	3.0	RRL	1	35	35	1	35	35	1	35	70
2	Drejtoria e Urbanizimit - Të hyrat nga lejet e ndërtimit- Procesi për nga lejet e ndërtimit.	3.0	RRL	1	35	0	0	35	0	1	35	35
3	Dre. Financave dhe pronës - Te hyrat	3.00	RRL	0	35	35	1	35	35	0	0	0
4	Drej. Shërbimeve publike - Ekzekutimi i buxhetit Menaxhimi projekteve	3.00	RRL	1	0	0	0	0	0	1	35	35
5	Drej. e Financave - Menaxhimi i pasurisë- (të hyrat nga Qiratë)	3.00	RRL	1	0	0	1	35	35	1	0	0
6	Drej. e Financave - Menaxhimi i sistemi të pagave	2.66	RRL	0	0	0	0	0	0	0	0	0
7	Drej. Administratës - Administratën komunale dhe Përdorimi i veturave Zyrtare	3.00	RRLM	0	35	35	0	0	0	1	20	20
8	Drej. e Arsimit - Ekzekutimi i buxhetit DKA	2.05	RRLM	0	0	0	0	0	0	0	0	0
9	Drej shëndetësisë - Ekzekutimi i buxhetit DSH	2.15	RRLM	0	0	0	1	20	20	0	0	0
10	Drej. Shërbimeve publike - Të hyrat në drejtorinë e Shërbimeve Publike	1.80	RRLM	0	0	0	0	0	0	0	0	0
11	Drej. e Kulturës - Ekzekutimi i buxhetit për subvencionet Drejtoria e Kulturës	2.00	RRLM	0	0	0	1	20	20	0	0	0
12	Drej. Kadastrit - Mbledhja e të hyrave në drejtorinë e Kadastrit	2.50	RRL	0	35	35	0	0	0	0	0	0

13	Drej. Për Bujqësi, Pylltari Dhe Zhvillim Rural	3.00	R R L	1	0	0	0	0	0	0	0	0
14	Drej. Administratës - Ekzekutimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet në drejtoria e administratës	2.10	R R M	0	0	0	0	0	0	0	0	0
15	Drej, Inspektionit - Mbledhja e të hyrave në drejtoria e inspektionit	1.55	R R M	0	0	0	0	0	0	0	0	0
16	Menaxhimi i Projekteve	3.0	R R L	1	35	35	1	0	0	1	20	20
17	Donacionet	1.25	R R U	0	0	0	0	0	0	0	0	0
18	Drej. Shërbimeve publike - Menaxhimi i bugjetit për ndriçimin publik	1.40	R R U	0	0	0	0	0	0	0	0	0
19	Drej. e Administratës - Shpenzimet komunale në drejtorinë e administratës.	1.15	R R U	0	0	0	0	0	0	0	0	0
20	Drej. Administratës - Menaxhimi i parkut të automjeteve	2.50	R R L	0	35	35	0	0	0	0	0	0
21	Drejtoria e Administratës - Ekzekutimi i buxhetit për shpenzimet e reprezentacionit	1.05	R R U	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali për detyrat në pajtim me vlerësimin e rrezikut dhe strategjinë e auditimit				5		140	6		155	6		160
Përcjellja e rekomandimeve				0	0	20	0	0	5	0	0	2
Detyrat për shërbime të konsulencës				0	0	25	0	0	2	0	0	0
Detyrat e auditimit që janë duke u zhvilluar				0	0	0	0	0	0	0	0	0
Puna tjetër e auditimit				0	0	2	0	0	0	0	0	0
Hetimet e mashtrimit				0	0	0	0	0	0	0	0	0
Numri i përgjithshëm i ditëve për aktivitetet e auditimit të brendshëm për NJAB						187			162			162
KEP/Numri i auditorëve												
Numri i auditorëve të nevojshëm				4		648	4		648	4		648
Pozitat e zëna të punës				2		324	2		324	2		324
Numri shtesë i auditorëve të nevojshëm				2		324	2		324	2		324

Udhëheqës i Njesisë
së Auditimit të Brendshëm
Z. Arbër Gola



Miratuar nga : Kryetar i
Komunës së Gjakovës.
Z. Ardian Gjini

